



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 20.05.2013, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavleviq, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Blerim Shala, Suzan Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj, Ismet Beqiri dhe Alma Lama.

Me ftesë: **Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagcilar.**

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri, Adelina Demolli dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi: Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të 22.04.2013 dhe 02.05.2013;
3. Raportimi i Ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagcilar;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet si vijon.

3. Raportimi i Ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagcilar

Kryetari- Tha se kemi prapë në diskutim çështjen e reformimit të administratës publike, e cila çështje konsideroi se do të bëhet kusht afatmesëm. Këshilli i Ministrave ka lejuar fillimin e negociatave dhe ka vlerësuar edhe punën e juaj, por për ne është shumë me interes të madh të shohim deri para 28 qershorit se ku kemi arritur me përmbushjen e sfidave dhe cila është sfida kryesore. Falënderoi për procedimin e materialit me kohë. E dimë që nuk je i vetmi ministër përgjegjës në këtë proces, pasi ministër koordinator është Kuçi.

Ministri- Njoftoi se është formuar Komisioni ndërministror i cili udhëhiqet nga zëvendëskryeministri në koordinim me ministrin e Administratës Publike. Ministria e Administratës Publike, nga aspekti ligjor

është përgjegjëse edhe për reformat e administratës publike edhe për zbatimin e disa çështjeve konkrete në administratën publike të administratës së Republikës së Kosovës. Sa i përket kritereve afatshkurtra që dalin nga Agjenda për Integrim Evropian, Ministria e Administratës Publike i ka përmbushur të gjitha obligimet në afat të paraparë. Janë aprovuar këto rregullore: Rregullorja për kushtet e kufizimit të së drejtës për grevë në shërbime të veçanta në Shërbimin Civil, Rregullorja për procedurat e përkujdesjes për nëpunësit civil për shkak të paaftësisë fizike apo mendore, ose problemeve shëndetësore dhe Rregullorja për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, po ashtu është nxjerrë vendimi për akomodimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Në kriteret politike kërkohet profesionalizimi dhe llogaridhënia e administratës publike në të gjitha nivelet. Janë planifikuar projektligji për procedurën administrative i cili projektligj është në fazat përgatitore dhe shpresojmë që shumë shpejt do të procedohet për miratim në Kuvend. Sa i përket projektligjit për IKAP, një herë ka qenë për miratim në Kuvend, por kanë qenë disa çështje e sidomos ajo e arsimimit të lartë, arsyet për kthimin e tij. Ne do t'i përmirësojmë këto vërejtje, por çështja e arsimimit të lartë kërkohet edhe me ligjin për shërbyes civilë dhe dokumente të tjera. Do të mundohemi që të bëjmë një transformim të institutit të administratës publike në një periudhë ndoshta pesë apo më shumë vjeçare, në një institucion arsimor. Sa i përket projektligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publik, për shkak të vërejtjeve të disa institucioneve dhe mos koordinimeve të nevojshme është tërhequr projektligji, pritet së shpejti të dërgohet për miratim, por për këtë projektligj nevojitet një koordinim me të gjitha institucionet, sepse është projektligji i cili nuk prek vetëm fushën e administratës publike, por shumë fusha të tjera sa i përket administratës shtetërore. Koncept dokumenti për inspektimin administrativ është në përpunim e sipër dhe besojmë që së shpejti sipas planit të dërgohet në Qeveri dhe më tutje në Kuvend. Koncept dokumenti për inspektimin e organeve të pavarura është aprovuar por mbetet të fitoj formën ligjore. Rregulloret për organizimin e brendshëm janë sfidë e madhe, për disa ministri është aprovuar kjo rregullore dhe po shpresojmë që deri në fund të kuartalit të dytë do të përfundojmë të gjitha organizimet e brendshme sa i përket të gjitha institucioneve qendrore. Kodi i mirësjelljes së shërbyesve civilë, është obligim i zyrës për Qeverisje të mirë pran zyrës së Kryeministrit, por sidoqoftë ne do të jemi bashkëpunues në hartimin e këtij kodi. Sistemi i ri i pagave në pajtim me rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës është një punë e cila është e ndërthurur edhe me miratimin e rregullores për klasifikimin e vendeve të punës. Gjithashtu po punohet në përfundimin e projektit informativ sa i përket qendrës së të dhënave dhe sistemit të ri të pagave i cili është bashkë me Bankën Botërore dhe i cili duhet të përfundohet deri në fund vitit. Analiza e ndikimit financiar të reformave kyçe është bërë sipas planit të veprimit për zbatimin e strategjisë së reformës së administratës publike, ku janë identifikuar të gjitha burimet financiare sa i përket realizimit të reformave. Sa i përket rekrutimit të stafit në departamentin për reformën e administratës publike tha ende nuk është ashtu si kërkojmë dhe si duhet të jetë. Sa i përket numrit të trajnimeve në IKAP, është duke vazhduar dhe besojmë se me miratimin e ligjit për IKAP, do të fuqizohet roli i institutit edhe nga numri i trajnimeve, por gjithashtu edhe në arsimimin e shërbyesve civilë. Për detaje të tjera tha ju kemi përcjellë raportin me shkrim.

Blerim Shala – Tha me gjasë do të ketë pasoja edhe për ministrinë e juaj gjatë integritit të strukturave paralele ekzistuese serbe, jo vetëm ne veri, por edhe gjetiu, sepse kemi edhe shërbyes civilë në katër komunat e veriut, ndërsa jo vetëm BE-ja, por edhe FMN-ja ka shprehur shqetësimin për numrin e madh të administratës publike në Kosovë. Andaj pyeti, a keni bërë farë analize, a do të ketë pasoja apo çfarë pasoja do të ketë në funksionimin e ministrisë suaj dhe në përmbushjen e kritereve prej momentit kur do të ndodhë integrimi i plotë i strukturave aktualisht ilegale të Serbisë në Kosovë?

Ministri- Tha se kjo është një çështje e cila duhet të koordinohet edhe me ministrinë e tjera, gjegjësisht me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, sidomos kur janë në pyetje aspektet financiare. Këto çështje nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me reformën e administratës publike. Ne, sipas udhëzimeve nga Qeveria, do të mundohemi të krijojmë kushte edhe për inkuadrimin e këtyre strukturave.

Vjosa Osmani- Pyeti a jeni të informuar në detaje nga zyra e Kryeministrit, si bartëse e procesit të dialogut lidhur me kriteret që ju do t'i parashtroni gjatë inkuadrimin, apo përfshirjes së strukturave të shërbimit civil që veprojnë në veri të Kosovës? A do të jetë ky proces i rregullt që do të shkoj përmes konkurseve, konfirmimit të përgatitjes profesionale, apo në mënyrë automatike do të inkuadrohen të gjithë, siç kanë qenë duke punuar në administratën në veri do të inkuadrohen në pozita ekuivalente në

institucionet e Kosovës? Ju thatë si sfidë kryesore keni depolitizimin e administratës, si pjesë e reformimit pas miratimit të bazës ligjore ka filluar procesi i klasifikimit të shërbyesve civilë në bazë të përgatitjes shkollore, profesionalizmit, përvojës. Pyeti çfarë masa ndërmerrni për verifikimin e propozimeve të cilat vijnë nga ministrinë e tjera për të parë nëse me të vërtetë janë përmbajtur kriteret, e jo të dërgohen listat me të afërm të ministrave të cilët nuk i plotësojnë kushtet domosdoshmërisht apo i merrni të gatshme ato lista dhe në bazë të tyre ju merrni vendimet?

Ministri- Tani për tani nuk kam ndonjë informatë, apo kërkesë të veçantë, andaj për të gjithë vlen ligji për shërbyes civil dhe ligjet e tjera dhe të gjithë duhen t'i përmbahen kësaj baze. Sa i përket depolitizimit të administratës tha është ligji për shërbyes civil, i cili konsiderohet si një ligj shumë modern, por që nevojitet vetëm implementimi i tij. Sa i përket verifikimit të listave të ministrive, sipas rregullores për klasifikimin e vendeve të punës duhet të themelohet Komisioni i përbashkët nga zyrtarët e Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, por që ky proces është i lidhur edhe me procesin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në të gjitha institucionet. Ky proces tha do kohë pasi çdo rregullore e brendshme e institucioneve qendrore duhet të kalojë për miratim në Qeveri për t'u bërë dokument zyrtar ndërsa për komunë klasifikimin e bëjnë në bazë të statutit. Mendojmë për të ardhmen do të formohet një trup inspektues i cili në të ardhmen do të inspektoj edhe këto çështje, por duke mos ndërhyrë në punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Tani ne do të veprojmë sipas dokumentacionit që kemi dhe në mënyrën më të drejtë të mundshme.

Vjosa Osmani- Ju e përmendët ligjin për shërbim civil dhe faktin që për momentin që çdo kush që do të donte t'i bashkohej administratës do të kalojë ato procedura, nëse merrni instruksione nga Qeveria si rezultat i dialogut duhet të ketë hyrje automatike të shërbimit civil, i cili ka vepruar si ilegal deri tani në institucionet e Kosovës, a mendoni se duhet të ndryshohet ligji për shërbimin civil, pra të amendamentohet?

Ministri- Së pari duhet të zbatohet ligji, për ndryshimet ligjore duhet të merret një vendim i përbashkët dhe ajo çështje kalon përmes instancave të caktuara.

Blerta Deliu-Kodra- Tha se jam shumë e kënaqur që është bërë zgjidhja e akomodimit të Ombduspersonit, pasi një çështje e tillë ka qenë edhe sfidë nga Raporti i Progresit për Kosovën. Pyeti sa po zbatohen vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe pyeti kur do të vij projektligji për pagat e zyrtarëve të lartë për miratim në Kuvend, pasi që dihet se në Kuvend ka qenë një debat i gjatë dhe është kthyer projektligji në Qeveri? Pyeti cilat ndryshime do të vijnë me projektligjin e ri?

Ministri- Tha se sa i përket sistematizimit të vendeve të punës jemi duke vepruar sipas ligjit. KPM është organi i pavarur i cili i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit, andaj ne jemi në rolin rekomandues dhe kërkues. Në të ardhmen duhet të shohim që të krijohet mekanizmi i atillë që të mos vijmë në situatën që të kemi një vendim dhe të mos zbatohet si duhet. Sa i përket pagave për funksionarët e lartë shtetëror tha unë kërkoj që një gjë e tillë të bëhet bashkërisht, sepse unë mund të vendosi për administratën publike, por kur vjen çështja e pagave të udhëheqësve duhet të punojmë së bashku, që të kemi në një sistem të unifikuar në Republikën e Kosovës. Për këtë çështje kërkoj ndihmën nga ana e juaj.

Blerta Deliu-Kodra- Kërkoj që gjatë rangimit të përfaqësuesve, përfaqësuesit e organeve publike të radhiten në pozitën e kërkuar, sepse ka qenë pak e pa arsyeshme pasi ata kanë pasur një rangim të lartë brenda kësaj liste të kategorizimit të këtyre pagave.

Ministri- Unë si ministër jam përgjegjës dhe jam i gatshëm të procedoj tutje, por për këtë duhet një bashkëpunim më i gjerë.

Albert Kinolli- Sa i përket raportit të studimit të fizibilitetit tha kam parë që në raportin e juaj keni identifikuar disa sfida cilat kanë të bëjnë me këtë raport, po më intereson cilat janë sfidat kryesore të identifikuara nga raporti i studimit të fizibilitetit dhe a keni kapacitete të mjaftueshme për momentin të përballeni me këto sfida.

Ministri- Sfida kryesore për këtë vit ka qenë realizimi i klasifikimit të vendeve të punës dhe përfundimi i organizimeve dhe sistematizimit të brendshëm të institucioneve. Do të krijohet një sistem i cili do të jetë i unifikuar dhe pastaj do të kalojnë këto çështjet e tjera siç janë inspektimi administrativ e trajnimeve. Këtë vit është përfundimi i këtyre reformave, ndërsa vitin e ardhshëm modernizimi i administratës publike dhe avancimi siç kërkohet edhe me ligje. Nga aspekti ligjor kemi përmbushur të gjitha veprimet por tani kemi vetëm zbatimin e tyre.

Kryetari- Tha e kuptojmë që procesi si i tillë është jashtëzakonisht i vështirë, i rëndë në implementim sepse kemi të bëjmë me një administratë jashtëzakonisht të madhe e cila është ndërtuar në periudha të ndryshme. Po ashtu tha me vendim të Qeverisë e kemi një laramani të zyrtarëve në administratë që tash do të keni për detyrë t'i standardizoni. Nuk e di sa është real, por në kuadër të inspektimit administrativ dhe mos disiplinës në organizata buxhetore, sidomos te pakicat po del që së paku 160 nëpunës civilë në Kosovë marrin rroga, por fizikisht kurrë nuk kanë qenë në Kosovë. Kanë hyrë me lista për interesa të caktuara, duke plotësuar kuotën. Ankesat vijnë nga njerëz që jetojnë në Kosovë, që ka konkurruar për të njëjtin vend pune, por që nuk ka mundur të punësohet. Një problem i tillë është paraqit në Lipjan, ku në sektorin e shëndetësisë është pranuar një teknik medicinal karshi njerëzve që jetojnë aty. Nuk e di sa ka kapacitet ministria të inspektojë këto raste sepse janë vepra penale dhe është e padrejtë ndaj njerëzve që jetojnë këtu e që kanë nevojë për një vend të punës, që ka nevojë organizata për një punëtor më shumë. Në njëqind mijë shërbyes civilë nuk është lehtë të detektohen rastet lehtë. Kërkoj që nëse është ky rast të konstatohet. A keni pasur këtë rast më herët, a ju është paraqitur më herët dhe a e keni shqyrtuar?

Ministri- Mua nuk më kanë ardhur drejtpërdrejt këto informata sepse është departamenti i shërbimit civil i cili merret me këto çështje. Jam në dijeni që janë duke u paguar ende disa kategori, sepse janë të trashëguara edhe prej kohës së UNMIK-ut. Tani kemi shansin që me klasifikimin e vendeve të punës një emër duhet të ketë një adresë. Deri në fund të vitit ne duhet të bëjmë klasifikimin e vendeve të punës për të gjithë nëpunësit civilë. Është plani që të hartojmë projektligjin për inspektimin administrativ që në të ardhmen të mos ndodhin rastet e tilla.

Vjosa Osmani- Në MPJ e kemi rastin që janë 600 deri 700 aplikues, që kanë aplikuar para një vit e gjysmë për pozita në staf diplomatik dhe konsullor. Për kundër faktit që po bëhen dy vite asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje, do të thotë janë në pritje e sipër, ku mos marrja e përgjigjes për një aplikim të tillë konsiderohet edhe shkelje e të drejtave të njeriut, përderisa po merren njerëz të cilët fare nuk kanë konkurruar dhe po plotësohen pozitat. A ka reaguar ndonjëherë ministria e juaj ndaj këtij rasti, sepse është numër i madh dhe së paku t'u jepet atyre një përgjigje që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese në ankesë dhe në procedura gjyqësore, sepse pa pasur një përgjigje nuk kanë edhe ku të ankohen në instanca të tjera?

Ministri- Tha se nuk mund të përgjigjem tani, sepse nuk kam informata të sakta. Në aspektin e përgjithshëm MAP është përgjegjëse për shërbyesit civilë, nëse janë këta në këtë kategori dhe kanë aplikuar në bazë të konkursit, unë do të analizoj situatën dhe do të shoh çfarë mund të veproj.

Vjosa Osmani- Tha se është çështja e afateve dhe kur duhet të përgjigjet institucioni përkatës vlen ligji për shërbimin civil. Ata çdo herë që publikojnë konkurs, ju njoftoi juve dhe marrin miratimin nga ministria e juaj, afatet brenda të cilave një institucion duhet t'i përgjigjet aplikuesve, qoftë ajo përgjigje negative janë të caktuara. Çështja e ambasadorëve është procedurë tjetër, sepse emërohen me një procedurë krejt tjetër, por për gjithë stafin tjetër procedurat e konkurrimit dhe marrjes së përgjigjeve janë të njëjta. Ata nuk kanë fare përgjigje në mënyrë që ta shfrytëzojnë, pastaj të drejtën e tyre kushtetuese për mjete juridike.

Ministri- Tha se ekziston edhe ligji për procedurat administrative i cili është në plotësim ndryshim, por ligji për procedurën administrative për çdo procedurë ka afate. Sa i përket shërbimit civil, ne kemi kompetencat, sa i përket shërbimit të jashtëm konsullor janë të caktuar sipas ligjit dhe për ta, po ashtu, vlen ligji për procedurën administrative. Unë do të analizoj se ku edhe sa kemi kompetencat në këtë pikë.

Kryetari falënderoi ministrin për gatishmërinë e treguar për të raportuar para komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të 22.04.2013 dhe 02.05.2013

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari- Tha se referues i projektligjit, paraqiti raportin për këtë projektligj. Projektligji nr. 04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional rregullon përcaktimin e tarifave të posaçme të akcizës për prodhuesit e vegjël të produkteve alkoolike dhe caktimin e metodës për përcaktimin e sasive dhe të përqindjes së alkoolit të produkteve alkoolike.

Pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis e BE- së.

5. Të ndryshme

a) Njoftim rreth vizitës së delegacionit të Maqedonisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se më 22 dhe 23 maj 2013, me ftesë të Komisionit për Integritet Evropian, në Prishtinë do të qëndrojë delegacioni i Maqedonisë në përbërje prej pesë anëtarëve, gjegjësisht anëtarët e Komisionit për çështje evropiane. Ku më 23 maj 2013, Komisioni do të ketë takim të përbashkët me delegacionin e Maqedonisë.

b) Vizita e Kryetarit të Komisionit për çështje evropiane i Turqisë

Kryetari i njoftoi se në muajin qershor, me ftesë të Komisionit për Integritet Evropian, planifikohet vizita e Kryetarit të Komisionit për çështje evropiane të Turqisë. Për detajet e tjera do të njoftohen me kohë.

c) Njoftim nga vizita në Këshillin e Evropës

Vjosa Osmani- Njoftoi se para dy javësh se bashku me deputetin Hydajet Hyseni kanë realizuar vizitën në Strasburg, në Këshillin e Evropës. Qëllimi i vizitës ka qenë që të raportojmë para Komisionit për çështje politike dhe demokraci lidhur me zhvillimet në Kosovës pas miratimit të rezolutës dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës. Tha është një zhvillim i mirë pasi që Këshilli i Evropës ka vendosur që përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës nga muaji qershor të jenë të ftuar dhe të kenë të drejtën e fjalës, përveç të drejtës së votës, në të gjitha komisionet e Këshillit. Është kjo hera e parë që për një shtet jo anëtar lejohen aranzhime të tilla. Njoftoi se kanë filluar një lloj koordinimi me MPJ, që si institucione të Kosovës të flasim me një zë. Propozoi që para çdo takimi në Këshill të Evropës, të diskutohet edhe në Komision për çështjet të cilat duhet t'i ngritin, përveç çështjeve të përgjithshme, sepse është shumë e rëndësishme marrja e informatave konkrete nga ana e kolegëve. Njoftoi se është duke u punuar për anëtarësim në Bankën e Këshillit të Evropës.

d) Njoftim lidhur me monitorimin e ligjit për ripranim

Blerta Deliu- Kodra- I njoftoi se kanë realizuar dy takime dhe se ka sfida të mëdha në këtë drejtim. Njoftoi se kanë rekomanduar që të ketë një qendër mjekësore, sepse marrëveshjet që janë nënshkruar me shtetet e ndryshme nuk janë paraparë trajtimet në aspektin shëndetësor, kishte raste të shpeshta të Hepatitit B, ku Kosova rrezikon që të ketë një epidemi në të ardhmen. Njoftoi se takimi i radhës do të jetë në Mitrovicë, për të parë se si është gjendja reale në terren.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lutfi HAZIRI